



Quality Endurance Passion

Gulf Coolant LL

FTOHËS GATI PËR PËRDORIM



Gulf Coolant LL

Gulf Coolant LL është një ftohës i cilësisë së lartë, i përbërë me Glikol Mono Etilen dhe ujë, i shtuar me një gamë të gjerë elementesh pa nitrat, amin apo fosfat. Gulf Coolant LL ofron mbrojtje të mirë për të gjitha metalet në sistemin e ftohjes dhe të motorit. Është neutral ndaj rondeleve dhe tubave prej gome dhe ka rezistencë të lartë kundër shkumës.

Gulf Coolant LL mund të përdoret gjatë gjithë vitit në sistemet e ftohjes në të gjithë motorët me benzinë dhe naftë. Falë paketës shtesë unike dhe të ekuilibruar me Glikol Mono Etilenit me cilësi të lartë, Gulf Coolant LL ka cilësinë më të lartë në treg duke ofruar mbrojtje efikase dhe afatgjatë kundër korrozionit falë një kombinimi të teknologjisë e re me silikat dhe karboksilat. Gulf Coolant LL duhet të përdoret i paholluar në sistemin e ftohjes. Gjithmonë referojuni manualit të OEM-së për llojin e rekomanduar të ftohësit!

Gulf Coolant LL rekomandohet për përdorim në sistemet ftohëse të të gjitha llojeve të motorëve industrialë dhe automjeteve me ftohje të lëngshme ose djegjje të brendshme.

Kujdes: Mbani të gjitha anti ngrirësit / ftohësit larg fëmijëve!!! Mos pini anti ngrirës / ftohës!!!

Nëse e përtypni, provokoni vjelljen dhe telefononi menjëherë mjekun!!!



Quality Endurance Passion

Gulf Coolant LL

SPECIFIKIMET



Plotëson specifikimet e: D3306 ASTM, BS 6580, AFNOR 15-601, SAE J1034, MB 325.0, JASO M325/JIS K2234, Behr, BMW-GS 9400, Cummins 85T8-2, Daimler-Chrysler MS-7170, Fiat-Lancia Fiat 9,55523, Iveco 18-1830, Volvo 128 6083/002, Opel / GM GME L1301, Saab 6901 599, Perkins, JI Case KPI-501, MAN 324 Lloji NF, MTU MTL 5048, VW TL 774C (G11)


Karakteristika	Metodat e testit:	Vlerat tipike:
Densiteti @ 20°C	ASTM D1122	1068 kg/m ³
Pika e Ngrirjes @ 40% antifriz & 60% uji	ASTM D1177	-40°C
Ngjyra	E Dukshme	Blu-Jeshil
pH @ 20°C (50% e holluar)	ASTM D1287	8.4
Kodi i Produktit: 6938	Data e lëshimit: 23/10/2012	Data e zëvendësimit: 05/07/2012
		Rishikimi nr: 04



Quality Endurance Passion

Gulf Super Brake Fluid DOT 4

ALKOOL FRENASH



Gulf Super Brake Fluid DOT 4

Gulf Super Brake Fluid DOT 4 është frenash me performancë të lartë, i prodhuar për përdorim në disqe, tambur dhe sistemet kundra bllokimit të frenave (ABS) për çdo automjet tregtar, makinë për pasagjerë dhe motorë që përdoren në kushte nga më të vështirat deri tek ato mesataret, të cilat kanë nevojë për alkool të tipit DOT 4. **Gulf Brake Fluid DOT 4**, për shkak të pikës më të lartë të saj vlimi, zbut efektet e përthithjes së lagështirës dhe siguron një frenim eficient.

Gulf Super Brake Fluid DOT 4 përmban përbërës frenues ndaj oksidimit dhe korrozionit për t'i rezistuar oksidimit në temperaturë të lartë, gjë që haset në sistemin e frenave në disqe dhe ofron mbrojtje të lartë kundër korrozionit të komponentëve metalikë në sistemin e frenave. Pika e lartë e vlimi e **Gulf Super Brake Fluid DOT 4** redukton impaktin e përthithjes së lagështirës në momentin e ndezjes dhe ofron performancë eficiente të frenave.

Qëndrueshmëria e lartë oksiduese i reziston oksidimit në temperatura të larta që ndeshen në sistemet e frenimit tek disqet; ka stabilitet të lartë në temperatura të larta dhe rrjedhshmëri në temperaturë të ulët gjë që siguron funksionimin pa probleme. Frenimi efektiv ndaj gërryrjes ofron mbrojtje afatgjatë kundër korrozionit të komponentëve metalikë të sistemit të frenave, rrëshqitshmëri dhe mbrojtje të sistemit.

Gulf Super Brake Fluid DOT 4 është në përputhje me të gjithë guarnicionet dhe metalet e përdorura në sistemet konvencionale të frenimit që kanë nevojë për alkool frenash poli glikol.

Gulf Super Brake Fluid DOT 4 rekomandohet për sistemet hidraulike të frenave tek makinat, motorët dhe mjetet tregtare ku DOT 4 është lloji i specifikuar i alkoolit të frenave. Gjithashtu për frenat me disk dhe tambur, përfshirë automjetet moderne të pajisura me ABS që kërkojnë alkool të cilësisë DOT 4; për të përmirësuar performancën e frenimit, ky alkool mund të përdoret edhe në sistemet hidraulike të frenave të automjeteve që kërkojnë alkool të cilësisë DOT 3 ose SAE J 1703 si dhe në sistemet hidraulike të friksionit që kërkojnë alkool të kësaj cilësie.

Gulf Super Brake Fluid DOT 4 nuk duhet të përdoret asnjëherë në vend të alkoolit të frenave me bazë silikoni apo të përzihet me të (DOT 5) dhe as nuk duhet të përdoret kur kërkohet alkool DOT 5.1. Të gjithë alkoolët e frenave duhet të mbahen në vend të pastër dhe të eë thatë. Papastërtia ose uji i ndotur mund të ndikojë në performancën e alkoolit të frenave dhe mund të shkaktojë prishje të sistemit të frenimit. Alkooli i frenave mund të ndikojë në lyerjen e makinës, kështu që tregoni kujdes nëse ju derdhet duke e hequr menjëherë pa e fërkuar.